



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-
Ministry of Trade and Industry

Procesverbal

Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës

Mbledhja e 9-të

Prishtinë, 14 janar, 2019, ora 09:00

Në mbledhje e 9

I. Morën pjesë

1. **Ramush Haradinaj** - Kryeministër
2. **Endrit Shala** – ministër i MTI-së - Kryesues i KKZHE-së
3. **Abelard Tahiri** – ministër i Drejtësisë
4. **Shyqiri Bytyqi** – ministër i MASHT-së
5. **Skender Reçica** – ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale
6. **Fatmir Gashi** – zv/ ministër i Ministrisë së Financave
7. **Arian Daci** – zv/ ministër i Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Str.
8. **Sazan Ibrahim** – drejtor ekzekutiv i Asociacionit të Komunave të Kosovë
9. **Rea Kryeziu** – përfaqësuese e Odës Ekonomike të Kosovës
10. **Arian Zeka** – kryetar i Oda Ekonomike Amerikane
11. **Lumnije Hajdini** – përfaqësuese e Aleancës Kosovare për Biznes
12. **Nora Hasani** – drejtoreshë e Oda Ekonomike Gjermane në Kosovë
13. **Shpend Balija** – drejtor i Këshillit Europian të Investorëve
14. **Dia Dobranja** – përfaqësuese e Forumit Ekonomik të Grave.

II. Pjesëmarrës/të ftuar të tjerë

1. **Errold Belegu** – Zyra e Kryeministrit;
2. **Albena Reshitaj** – Zyra e Kryeministrit;
3. **Haki Shatri** – Zyra e Kryeministrit;
4. **Besa Ilazi** – USAID;
5. **Dardane Peja** – USAID;
6. **Corinne Deleu** – Zyra e BE-së në Kosovë;
7. **Blerta Qerimi** – Banka Botërore
8. **Besim Zeqiri** – Banka Botërore/IFC;
9. **Leonora Kusari** – BERZH;
10. **Lendita Daija** – BERZH/ Sekretariati i KKZHE-së;
11. **Ahmet Zejnullahu** – Kryeshef i Agjencisë së Pyjeve të Kosovës/MBPZHR;
12. **Musa Limani** – Zyra e Kryeministrit;

RENDI I DITËS

- 09:00-09:05 Hapja e takimit
- 09:05-09:15 Fjala hyrëse e Kryeministrit Haradinaj
- 09:15-09:20 Miratimi i Rendit të Ditës të Mbledhjes së Nëntë të KKZHE-së
- 09:20-09: 50 Raportimet për veprimet e ndërmarra lidhur me temat e diskutuara në mbledhjen paraprake të KKZHE-së:
- Ligji nr. 03/L-212 Ligji i Punës (Ministria e Punës & Mirëqenies Sociale)
 - Ligji nr. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave (*Ministria i Financave*)
 - Ligji nr. 03/l-064 për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës (*Zyra e Kryeministrit*)
 - Shkëmbimi i informatave të klientëve në mes të QRK-së dhe sektorit financiar (*Shoqata e Bankave*)
- 09:50-10:30 Temat e reja të propozuara nga Asociacioni i Komunave të Kosovës
- Amandamenti i Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale (Ligji nr. 04/L-144)
 - Amandamenti i Ligjit për Partneritetet Publiko-Private (L nr. 04/L045)
 - Menaxhimi i pronave të "Ekonomisë së Pyjeve" që menaxhohen nga Agjencia e Pyjeve e Kosovës (MBZHR).
- 10:30-10:45 Temat e propozuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
- Bashkëpunimi në mes të shkollave profesionale dhe bizneseve private për aftësimin e kuadrove të reja profesionale
- 10:45-10:55 Përmbyllja e takimit të KKZHE-së (propozimi i temave të reja dhe caktimi i datës për mbledhjen e ardhshme) – *Ministri i Tregtisë dhe Industrisë*

MTI, Ministri z. Endrit Shala:

I nderuar Kryeministër i Republikës së Kosovës,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Të nderuar kolegë ministra, zëvendësministra dhe përfaqësues të tjerë institucional,
Të nderuar përfaqësues të asociacioneve të biznesit,
Të nderuar përfaqësues të misionëve diplomatike të ShBA-ve dhe të BE-së në Kosovë,
Të nderuar përfaqësues të donatorëve ndërkombëtar në Kosovë dhe përfaqësues të Bankës Botërore,
Të nderuar anëtarë të KKZHE-së,

Me lejoni që fillimisht, të ju përshëndes përzemërsisht dhe të ju uroj mirëseardhje në mbledhjen e nëntë të këshillit kombëtar për zhvillim ekonomike të Kosovës.

Edhe pse nuk kemi mbajtur shumë takime formale, që nga ri-funksionalizimi i këtij Këshilli, i cili kryesohet nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, ne si institucione pjesëmarrëse së bashku me komunitetin e biznesit, kemi qenë mjaft aktiv në punët tona të përbashkëta për të adresuar me prioritet të gjitha sfidat kryesore dhe për të zbatuar reformat gjithëpërfshirëse që kanë për qëllim përmirësimin e ambientit të të bërit biznes, eliminimit të barrierave, forcimit të ndërmarrjeve të Kosovës, tërheqjen e investimeve të huaja direkte në vend.

Duke u nisur nga fakti se Qeveria e Kosovës ka shpallë vitin 2019 si "VIT TË EKONOMISË" ne si institucione pjesëmarrëse në këtë forum publiko – privat do të japim kontributin tonë për të ngritur dhe diskutuar shumë çështje që do të ndikojnë pozitivisht në sferën ekonomike, në aktivitetin e shtuar të bizneseve, në rritjen e investimeve të huaja direkte në vend dhe në fund në përmirësimin e jetës së qytetarit të Kosovës. Për të diskutuar më gjerësisht për këto çështje unë ia kaloj fjalën Kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, që njëherë-it është edhe Kryesues i Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik. z. Kryeministër, fjala për ju

Ramush Haradinaj – Kryeministër:

Mirëmëngjesi ministër Shala, mirëmëngjesi të nderuar ministra, kolegë, mirëmëngjesi përfaqësues të odave që jeni prezent, njëkohësisht të të gjitha institucioneve tjera që jeni bashkë sot në KKZHE.

Jemi në fillim të këtij viti, pra ende mund ta quajmë fillim, është pjesa e parë e muajit të parë, shfrytëzoj rastin me ju uruar këtë vit si vit i suksesshëm dhe të jete i suksesshëm në misionin e secilit që kemi por edhe në misionin tonë të përbashkët. Viti 2018 pra viti që shkoi ka qenë më shumë një vit i infrastrukturës ligjore edhe të sigurisë, pra rend, ligj dhe siguri. Fokusimi ka qenë më i madh ndoshta edhe e kuptueshme pse, por viti 2019 është vit i ekonomisë dhe do të kthehem seriozisht temave ekonomike, pra riaktivizimin e mirëfilltë të KKZHE-së, krijimin e Sekretariatit të përherëshëm të KKZHE-së në mes të MTI-së dhe ODA-ve ashtu si kemi ra dakord dikur, Oda Ekonomike e Kosovës, Oda Ekonomike Amerikane, Oda Ekonomike Gjermane, me ekspert të përgatitur për të përgatitur takimet apo propozimet për këtë formë të gjerë të takimeve. Edhe pse në Kosovë e kemi politiken tatimore më të volitshme në rajon, Qeveria dëshiron të dëgjoj bizneset me tutje për reformat dhe veprimet tjera që lidhen me investitorët të huaj; kemi dëgjuar që veç tani janë 11 (njëmbëdhjetë) investitorë të huaj potencial strategjik të paraqitur dhe njëkohësisht e dini për investimin më të madh që pritet të jetë në fazën implementuese; fjala është për kompaninë "Contour Global" për investime në energji. Ne duhet të vazhdojmë së bashku, në fushën fiskale, Ligji për Tatim i të Ardhurave për Korporatat, Tatimi në të Ardhura Personale, d.m.th ka kaluar në leximin e parë; Ligji për TVSH dhe për Administratën Tatimore dhe Përgjegjësitë tanimë është proceduar në Kuvend.

Kuptohet që para nesh mbetet çështja e in-formalitetit edhe duhet të jemi bashkë ta trajtojmë me kujdes edhe këtë temë. Janë edhe disa ligje tjera si: Ligji për Paga, Ligji për Festat Zyrtare, Ligji i Punës dhe disa nga prioritete për lehtësira në biznes. Sikurse jeni të informuar, pra në disa prej këtyre ligjeve ka përparime e në disa jo. Ligji i Punës është 03/L-212, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është miratuar edhe është përcjellë në Parlament, ky ligj edhe po ashtu ajo që është me rëndësi është formula e gjetur për çështjen e lehonisë që nuk i ngarkon më sipërmarrësit pos 3 muaj. Ka plot ligje tjera, si: Ligji për Tatimin e të Ardhurave të Korporatave që është në Kuvend nga muaji shtator dhe tanimë ka kaluar leximin e parë dhe duke mos dashur të ju mbaj shumë dua të ju them që Ligji për Festat Zyrtare nuk ka avancim, ka mbetur ashtu si ka qenë dhe duhet të trajtohet me kujdes, pastaj një temë që poashtu ka qenë e evidencuar këtu në të kaluarën, shkëmbimi i informatave të klientëve në mes të QRK-së dhe sektorit financiar.

Ne kemi plot sfida ne Kosovë, kultura e implementimit pra zbatimi është dobësi jonë, ne nuk është se nuk i hartojmë dokumente, strategji, ligje, akte normative, udhëzime administrative, plot por dobësitë tona hetohen shumë kur bëhet fjalë për implementim e tyre. Ne falënderojmë shumë gjithë partneret ndërkombëtarë që sjellin nga ekspertizat e tyre, nga përvoja dhe dija e tyre mirëpo ekzistenca e KKZHE-së, duhet tash të dëshmohet me veprimet që burojnë nga ky Këshill pra kjo është tavolina jonë dhe kisha kërkuar nga gjithë ju që të biem dakord që takimet ti kemi mujore dhe nëse i mbajmë mujore nuk ka nevojë të jenë shumë të gjata dhe nëse janë mirë të përgatitura, me rend dite të qartë, dhe me tema të trajtuara më herët, jam shumë i sigurt që këto takime do jenë edhe efektive pra nuk do të jenë vetëm takime të bisedave. Personalisht e kam vlerësuar shumë të rëndësishëm që gjatë këtij viti të mbesim të fokusuar në ekonomi, në ekonomi, në ekonomi dhe nuk është vetëm fjalë mirëpo me gjithë sfidat që kemi nuk do ti ndalemi këtij qëllimi. Unë ju falënderoj shume dhe propozoj që më tutje takimin ta vazhdoj kryesuesi, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë z. Endrit Shala.

Endrit Shala, Ministër i MTI-së:

Ju faleminderit Kryeministër!

Para se te filloj me rendin e ditës të cilin të gjithë e keni para jush, unë ashtu siç e përcakton edhe Rregullorja dëshiroj që fillimisht ta konstatojmë kuorumin. Sipas Rregullores, Këshilli ka kuorum kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtareve. Unë kam marr konfirmimin për pjesëmarrje nga pothuajse të gjithë anëtarët e KKZHE-së. Do të thotë kemi kuorum se të pranishëm janë me shumë se shumica e anëtareve dhe mund të vazhdojmë me punën.

Dëshiroj të kërkoj konfirmimin tuaj formal edhe për **rendin e ditës** së mbledhjes së sotme. Siç e keni parë, në agjendën e takimit të sotëm kemi përfshirë të gjitha pikat nga takimi i fundit në mënyrë që të përcjellim e bërë nga mbledhja e fundit por kemi përfshirë edhe propozimet e reja që i kemi pranuar në ndërkohë nga anëtarët e KKZHE-së. Në pikën e fundit, ne do tu japim mundësinë që të bëni edhe propozime për mbledhjen e radhës ashtu siç e tha edhe kryeministri dhe a jeni te pajtimit te vazhdojmë me këtë rende te dite qe e keni para jush?

Ramush Haradinaj, Kryeministër:

Me falni! A mund që sot të vendosim edhe për takimet mujore dhe do të ishte mirë ta bëjmë kështu dhe ju e dini kohën a është më mirë ta mbajmë në fillim të muaji apo gjysmë të muajit apo keni ndonjë vlerësim nga ju dhe kisha pas dëshirë të mbetet në transkriptim që vetë kemi vlerësuar cila është koha më e duhur, po supozojmë sot jemi me datën 14-të dhe me 14 shkurt të muajit që vjen nuk guxojmë. Mundemi ose në pjesën e parë ose në pjesën e dyte, por meqë e kemi Festën e

Pavarësisë atëherë në pjesë e dytë të muajit shkurt dhe a do të ishte në rregull me 22 ose 23 shkurt me e gjetë një datë të tillë. Besoj po. Atëherë nëse bënë me u shti edhe propozimin për takime mujore gjatë këtij viti, pra ky është i pari dhe do të kemi 12-të takime.

Endrit Shala, Ministër MTI:

Atëherë dakordohemi që takimet ti mbajmë mujore dhe takimi i radhës mbetet të mbahet në pjesën e dytë të muajit shkurt. Sekretaria e KKZHE-se, unë besoj se deri në shkurt do të jetë e finalizuar dhe do të njoftoheni me kohë edhe për datën e saktë të takimit, i cili këtu po vendoset që të jetë - pjesa e dytë e muajit shkurt. U pajtuam për rendin e ditës dhe poashtu kisha kërkuar nga ju që të bëjmë aprovimin formal edhe të procesverbalit të mbledhjes së tetë të KKZHE-së, Sekretariati e ka dërguar me kohë këtë dokument për rishikim tek të gjithë anëtarët dhe ne nuk kemi pranuar komente dhe konsideroj që Këshilli mund sot ta aprovoj këtë procesverbal. A jemi të gjithë që ta aprovojmë procesverbalin? Atëherë aprovohet procesverbali dhe vazhdojmë me pikat e rendet të ditës. Pika e parë e rendit të ditës është **“Raportimet për veprimet e ndërmarra lidhur me temat e diskutuara në mbledhjen paraprake të KKZHE-së”**. Në këtë pikë do të flasim për çështjet që janë ngritur në takimin tonë të fundit dhe pika e parë është **“Plotësim – Ndryshimi i Ligjit të Punës (Ligji nr. 03/L-212)”**. Fillimisht ftoj, Ministrin Skender Reçica të paraqes progresin e bërë lidhur me këtë çështje, dhe më pastaj rreth kësaj teme mund të flasin edhe përfaqësuesit nga komuniteti i bizneseve.

Ministër Reçica e keni fjalën...

Skender Reçica – Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale:

Mirëmëngjesi gjithëve, ju faleminderit ministër Shala, i nderuar Kryeministër, të nderuar kolegë ministra, të nderuar të gjithë ju të pranishëm!

Atëherë më lejoni që në pika të shkurtra të ju jap një informacion në lidhje me veprimet të cilat i kemi ndërmarr sa i përket reformës së trajtimit të marrëdhënies së kontraktuarë punëdhënës, punëmarrës dhe lehonisë. MPMS ka adresuar veprimin për iniciativën ligjore drejt reformës për ligjin e punës ashtu siç është definuar në takimet e KKZHE-se. Me fillim e zbatimin të planit vjetor të punës për vitin 2018, kemi hartuar draft koncept dokumentin për rregullimin e fushës nga marrëdhënia e punës, kemi adresuar çështjet nga marrëdhënia e punës duke u fokusuar edhe në dispozitat e pushimit të lehonisë, orarit të punës, kontratat e punës, marrëveshjes kolektive dhe shume çështje tjera. Koncept dokumenti është miratuar në qeveri me 22 qershor 2018 në bazë të të cilit koncept kane buruar dy projekt ligje: projekt-Ligji i ri i Punës dhe projekt-Ligji për Pushimin e Lehonisë (apo prindëror).

Projekt-Ligji i Punës është ligj bashkëkohorë i cili përmirëson të gjitha çështjet nga marrëdhënia e punës dhe në këtë projekt-ligj janë transpozuar 15 direktiva të Bashkimit Evropian, janë marrë praktikat më të mira të BE-së dhe janë eliminuar çështjet të cilat kanë qenë problematike në ligjin aktual të punës. Ky projekt-ligj është hartuar edhe në bashkëpunim me ekspert më të mirë të angazhuar nga Komisioni Evropian; është konsultuar edhe me organizata ndërkombëtare si Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar por edhe me organizata vendore të Punëdhënësve dhe Punëmarrësve dhe kemi pasur edhe mbështetjen e tyre. Tash, ky projekt-ligj është miratuar në Qeveri me 24 dhjetor 2018 dhe është përcjellë në Parlament.

Bazuar ne koncept dokumenti për marrëdhënien e punës, Ministria e Punës ka hartuar projekt-Ligjin për Pushimin e Lehonisë dhe Prindëror, ku projekton dhe avancon të drejtat gruas në marrëdhënien e punës. Ku projekt ligj rregullon pushimin e lehonisë dhe të atësisë ku janë transpozuar direktivat e BE-se. Projekt-Ligji parasheh që pushimi të jetë në total 12 muaj, e që 3 muajt e parë paguhen nga punëdhënësi me 70% të pagës bazë, 6 muaj nga Qeveria me 50 % e pagës mesatare në vend dhe 3 muajt e tjerë pa pagesë jo-obligative. Ky projekt-ligj, bazuar në direktivat e BE-se parasheh edhe pushimin prindëror pa pagesë për 4 muaj për secilin prind deri sa fëmija të mbushë moshën dy vjet.

Duke marr parasysh rrethanat socio-ekonomike dhe ato demografike të vendit për herë të parë, trajtimin e lehonave dhe në bazë të këtij ligji do te përfitojnë afat prej 6 muaj, një kompensim mujor në vlerë të caktuar të pagës minimale në vend. Ne konsiderojmë që masa e marrë në projekt-Ligjin e lehonisë si dhe shkurtimi i kohëzgjatjes së pushimit të lehonisë të paguhet nga punëdhënësi dhe rregullimi i orarit te punës për shkak te gjë-dhënies janë masa të cilat mbrojnë dhe avancojnë shkallën e punësimit të grave te reja. Ky projekt-ligj është nxjerr si projekt-ligj i veçantë sepse në të ardhmen, punëdhënësit do të lirohen nga përgjegjësia e kompensimit të pushimit të lehonisë bazuar në reformat pensionale ku do te instalohet sistemi i sigurimeve sociale, bazuar në standardet ndërkombëtare të ILO-së. Ky projekt-ligj është dërguar për miratim në Qeveri dhe shpresojmë që së shpejti të miratohet për shkak se projekt-ligji i punës si i vetëm nuk parasheh rregullimin e pushimit te lehonisë. Dua të ju informoj se me nënshkrimin e Marrëveshjes për Stabilizim – Asociim, Kosova ka marrë për obligim të bëjë transpozimin e direktivave të BE-së, dhe me këtë rast dua të ju njoftoj se zyra BE-së në bazë të projektit të IPA-së na ka ndihmuar në këtë proces. Të dy projekt-ligjet kanë qenë në konsultime publike dhe gjithashtu kemi qenë pjesëmarrës në tryeza të organizuara si me punëmarrës ashtu edhe me punëdhënës të cilët kanë mirëpritur këto dy projekt ligje. Ju faleminderit!

Endrit Shala, Ministër MTI

Ju faleminderit ministër Recica

Nga komuniteti i bizneseve, kush do të marri fjalën. Urdhëroni...

A dëshiron dikush tjetër të flas në lidhje me këtë çështje?

Pika e radhës është Plotësim Ndryshimi i Ligji nr. 05/L-029 për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave si dhe një varg i çështjeve të ngritura nga komuniteti i biznesit. Prandaj ftojme zv. ministrin Fatmir Gashi nga Ministria e Financave që ta marr fjalën dhe të na informoj për progresin e bërë...

Fatmir Gashi – zv/ministër i Ministrisë se Financave:

Ju faleminderit ministër, i nderuar z. Kryeministër, të nderuar ministra, zv ministra, të nderuar të pranishëm.

Ministria e Financave është duke punuar me përkushtim në mbështetjen e bizneseve vendore përmes hartimit të politikave adekuate fiskale dhe konkrete të cilat konsistojnë në lirime tatimore për lendën e parë, makinerinë, linja të prodhimit si dhe komponentët tjera të aktiviteteve prodhuese dhe të cilat janë duke dhënë efekte konkrete në rritjen e prodhimit, eksportin dhe rritjen e vendeve te reja te punës. Po ashtu ne kemi hartuar, gjatë kësaj kohe, edhe ndryshimet ligjore, pakon e ligjeve tatimore të cilat Kryeministri në fjalën e vet të hyrjes i përmendi, janë prej Ligjit të Korporatave,

Tatim të Ardhurave Personale, Ligji për TVSH-në dhe Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe të gjitha këto ligje janë në procedurë të aprovimit në parlament. Sot do të flasim për Ligjin mbi Tatimin e te Ardhurave të Korporatave dhe unë do të cekim që edhe ky ligj është dërguar në bashkëpunim të ngushtë në mes të MF-së dhe asociacioneve të biznesit të cilët kanë dhënë propozimet e tyre të cilat propozime 99% janë inkorporuar në projekt-ligjin e ri.

Në fillim kemi menduar të shkojmë me plotësim ndryshim të ligjit mirëpo pasi që kemi marrë kërkesat nga biznesi kemi parë që duhet të shkojmë në projekt-ligjin e ri dhe kemi hartuar projekt-ligjin e ri. Çka ka qenë e meta kryesore të Ligji mbi Tatim në të Ardhurat e Korporatave ka qenë industria financiare sidomos Kompanitë e Sigurimit të cilat me vite të tëra kanë qenë të tatimuar kinse me tatim të korporatave mirëpo ajo faktikisht ka qenë tatim në qarkullim dhe ka qenë tatim në premi të sigurimit. Ne, pasi që kemi marrë propozimet nga shoqatat edhe të bankave edhe të sigurimeve edhe të Komitetit të Investitorëve Evropian, kemi analizuar dhe të gjitha ato i kemi inkorporuar në ligj dhe kështu që edhe bankat nuk do të kenë problem me kreditë e këqija edhe kompanitë e sigurimit nuk do të tatimohen në qarkullim mirëpo do të tatimohen në të ardhurat e veta dhe kjo është e konceptuar në ligj. Në këtë ligj çka është dhe një çështje shumë me rëndësi, në ligjin e vjetër tatimi i mbajtur në burim për personat fizik (jo afarist) ku hynë bujqit, fermerët, mbledhësit e materialit për riciklim, mbledhësit e bimëve shëruese etj, kanë qenë të paraparë dhe të tatimuar me 3% dhe ne kemi propozuar të tatimohen me 1%. D.m.th të gjithë këto dhe çështjet tjera të cilat kanë qenë procedurale janë përmirësuar dhe janë shumë më mirë të rregulluara me këtë ligj dhe siç e tha edhe Kryeministri janë në procedura parlamentare që kanë kaluar edhe Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe ata i kanë dhënë sugjerimet e veta të mëtutjeshme dhe presim që seancat e parlamentit të cilat do të mbahen do të aprovohet ky ligj dhe do të hynë në fuqi.

Edhe Ligji mbi TVSH-në, ju jeni të njoftuar që kanë kaluar procedurat është në Kuvend dhe ai ka kaluar leximin e parë dhe pritet që të aprovohet. Kryesorja në atë ligj përjashton shumë çështje të tjera por më kryesorja është që Tatimi i Vlerës së Shtuar tash do të mblidhet në brendi, nuk do të mblidhen në doganë dhe është i paraparë ky ndryshim. Është faza e parë e kësaj mënyrës të mbledhje së taksës dhe në të ardhmen do të shkojmë në faza tjera të do të japin edhe afate me të gjata për mbledhjen e TVSH-së në brendi. Kjo fazë do të jetë që TVSH-ja do të mblidhet në brendi pasi ta importon mallin d.m.th. se e importon këtë muaj, deri në majin tjetër do të duhet të paguaj në doganë, kështu ka qenë e konceptuar në fazën fillestare dhe shpresojnë që duke ngritur kapacitetet e administratës ne do të shkojmë edhe në zgjatjen e këtij afati pagesës.

Kemi Ligjin mbi të Ardhurat Personale i cili është në procedurë parlamentare edhe ajo është në fazën e leximit të parë dhe se fundi është Ligji mbi Administratën Tatimore dhe përgjegjësitë, ky ligj është kërkesë e biznesit që e kemi kërkuar që të kthehet Bordi i Ankesave dhe në ligj është propozuar formimi i Bordit të Ankesave dhe ajo të bëhet në Administratën ashtu si ka qenë përpara dhe ajo është futur në ligj ku është pranuar kërkesa e biznesit. Jam i hapur edhe për çështje tjera në qoftë se kenë diçka. Ju faleminderit kryesues!

Endrit Shala, Ministër MTI

A doni dikush që të shtoni diçka lidhur me çështjen në fjalë?
Urdhëroni Aleanca Kosovare e Biznesit

Lumnije Hajdini – Përfaqësuese e AKB-së

Përshëndetje kryesues, anëtar të KKZHE-së! Unë në emër të AKB-së, dhe z Shahinit - Kryetarit të AKB-së, ju dëshiroj një vit të mbarë. Sa i përket AKB-se, ka qenë edhe kërkesë edhe në mbledhjen e fundit të KKZHE-së që sipas rregullores takimet e këtij këshilli të mbahen çdo muaj, kjo është miratuar dhe e përshëndesim edhe Ministrinë e Financave, ne e kemi vlerësuar dhe ka qenë kërkesë e kamotshme për rikthimin e Bordit të Pavarur të Ankesave mirëpo çfarë po propozojmë ne si AKB qe ne këtë bordin e pavarur tash se kemi qene kamotshëm për 4 vite kemi radhazi kemi kërkuar qe ne këtë Bord të Ankesave te mos këtë ndërhyrje politike për arsye se kemi një mori të lëndëve që janë në konteste se në divizionin fiskal janë me mijëra raste që nuk janë shqyrtuar dhe nuk janë zgjidhur.

Sa i përket ligjit për të ardhurat e korporatave, ne si AKB dhe gjithë partnerët e mi kemi adresuar dhe kemi bërë shtytje që ligji për të ardhura e korporatave, në vitin 2019 ta gjej të aprovuar ne Kuvend për shkak te viti kalendarik qe e kemi dhe duke pas parasysh rrethanat qe kjo ka nevojë apo ne fakt kemi dështuar ne këtë aspekt. Sa i përket ligjit për TVSH ne kemi menduar qe këto tri ligje nga ministria e financave dhe e vlerësojmë lart qe këtë vite 2019 te jene te aprovuar ne kuvend mirëpo tash po ballafaqohemi ende dhe prodhuesit tanë ne administratën tatimore dhe doganore i kane për me udhëzim administrativ ende aplikojnë për lirim nga TVSH-ja. Me këtë ligj ne te ardhmen do ta lehtësoj biznesit qe mos për çdo vit te aplikojnë për lirim te TVSH ne administratën tatimore, mirëpo sa i përket ligjit edhe për administratën tatimore ne i kemi dhen edhe vrenjtje edhe te gjitha janë inkorporuar dhe vetëm ne bordin e pavarur te kemi ekspert te fushave ne te ardhmen qe do ti kontribuoj zgjidhjes se kontesteve ne afat me te shkurt sepse kjo mund ti kontribuoj edhe klimës edhe ambientit për ankesa ne Kosove

Endrit Shala, Ministër MTI:

Dikush tjetër a dëshiron te flas?

Atëherë, temë tjetër që është diskutuar në takimin e fundit ka qenë edhe Plotësim Ndryshimi i Ligji nr. 03/L-064 për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës. Për këtë temë e ftoj përfaqësuesin nga Zyra e Kryeministrit të na informoj se çka është ndërmarrë lidhur me këtë çështje.

Z. Belegu fjala është për ju...

Erold Belegu - Zyra e Kryeministrit (ZKM)

Unë kam biseduar me Ministrin e Administratës Publike dhe ka qenë iniciativë nga Kuvendi që të fillojnë ndryshimet në Ligjin për Festat Zyrtare e cila nuk ka mbërritur askund, nuk është zhvilluar prandaj nëse Qeveria e autorizon Ministrin mund të fillohet menjëherë dhe me sa e di unë dy kërkesat kryesore nga biznesi janë: që mos të zëvendësohen ditët e vikendit dhe të largohet 9 Maji nga kalendari i festave zyrtare. Këto dyja janë pak a shumë, prandaj është procedurë e lehtë por duhet një initiative e Qeverisë për ti dhënë instruksione Ministrit përkatës që të fillohet me përgatitjen e ligjit.

Ramush Haradinaj – Kryeministër

Fakti se është plotësim/ndryshim, do të thotë ligji ekziston dhe këto plotësim/ndryshimet a janë të akorduara në këtë Këshill për shembull?

Erold Belegu – Zyra e Kryeministrit (ZKM):

Në prill të vitit 2013 janë ta aprovuara, është kërkesë e bizneseve....

Endrit Shala, Ministër MTI

Pikë e rëndësishme është shkëmbimi i informatave dhe bashkëpunimi ndër-institucional në mes të institucioneve të ndryshme në Kosovë. Një iniciativë e tillë është ngritë nga Shoqata e Bankave për të bërë shkëmbimin e informatave të klientëve të saj nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve e Kosovës (ARBK) dhe Agjencia për Regjistrim Civil (ARC) me sektorin financiar. Unë po e shoh që z Balija nga shoqata e bankave nuk është këtu mirëpo lidhur me këtë temë informatat që kam marrë nga zyrtarët e ARBK-së që kanë qenë të përfshirë në këtë proces po ashtu ma kanë konfirmuar se vlerësimet e dhëna nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (AMDP) konfirmojnë se një shkëmbim i mundshëm i këtyre informatave paraqet një shkelje të ligjeve ekzistuese dhe e vetmja mënyrë për të mundësuar këtë është plotësim-ndryshimi i ligjeve përkatëse që janë në fuqi. Ne do të vazhdojmë konsultimet edhe me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe me institucionet tjera të sigurisë për të vlerësuar cenimin e sigurisë së këtyre dhënave dhe në rast të rekomandimit të tyre mund të iniciojmë edhe procesin e plotësim-ndryshimit të ligjeve të lartpërmendura.

Sekretaria e KKZHE-se varësisht nga detyrat që dalin për të kërkuar nga secila ministri mendimet në raport me secilën pyetje...

Ramush Haradinaj Kryeministër

Sekretaria a është funksionale?

Endrit Shala, Ministër MTI

Ende jo mirëpo shumë shpejtq do jetë funksionale...

Ramush Haradinaj – Kryeministër:

Kur mundet me qenë?

Besim Zeqiri - përfaqësues nga MTI-ja:

Z. Kryeministër, jemi në fazën e përfundimit të përzgjedhjes së anëtarëve të Sekretarisë dhe ky proces po kryhet prej Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) të cilët janë duke e

mbështetur MTI-në, në fuqizimin e Sekretarisë. Ne, kabineti i MTI-së, për momentin jemi duke e luajtur rolin e Sekretarisë dhe duke i bërë përgatitjet për këtë mbledhje dhe mbledhjet e ardhshme.

Ramush Haradinaj - Kryeministër

A ka mundësi ju si kabinet i MTI-së të merrni për sipër detyrat që i takojnë Sekretariatit deri sa nuk është funksional, me i zbatuar p.sh nëse ne dëshirojmë të mbajmë takimin e ardhshëm në fund të shkurtit, ju do të duhej që deri kah data 10 shkurt me pasë të kryer këtë kërkesë dhe përgjigjen që vjen prej Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe ne ti kemi ato materiale këtu. Ne mundemi të pajtohemi me këto, mundemi të diskutojmë mbi to dhe a është koha reale për ju? Dhe mbetet që ju me 10 shkurt ta na njoftoni me te arritura e organizmit. Ju faleminderit

Endrit Shala, Ministër MTI

Në këtë pikë do të flasim për temat e propozuara në ndërkohë nga anëtarët e KKZHE-së. Asociacioni i Komunave të Kosovës ka qenë mjaft aktiv dhe ka propozuar tri tema të ndryshme që janë përfshirë në agjendën e sotme. Lidhur me temën e parë që është Plotësim – Ndryshimi i Ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale (Ligji nr. 04/L-144). Fillimisht ftoj z. Sazan Ibrahimimi nga AKK që ta prezantoj këtë kërkesë, dhe më pastaj rreth kësaj teme do të flas edhe përfaqësuesit nga Ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal (MAPL).

Sazan Ibrahimimi – AKK

Ju faleminderit kryesues, i nderuar Kryeministër, të nderuar ministra, zv/ministra, anëtar të KKZHE-së, së pari ju urojme edhe ne vitin e ri 2019, është shumë mirë që ky vit është shpallur si vit i zhvillimit ekonomik dhe besoj që do të këtë ndryshime sa i përket legjislacionit për zhvillimin ekonomik por edhe të proceseve tjera. Sa i përket pikës së parë, unë ju informoj (sepse ne e kemi propozuar tri pika) se në pikën e parë ka pasur shumë zhvillime pozitive, Ligji për Dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim ka kaluar amandamentimi i këtij ligji në lexim të parë në Parlament.

Mund të themi që gjitha rekomandimet që kanë ardhur nga Komunitet e Kosovës janë inkorporuar në Ligjin final i cili ka kaluar në leximin e parë dhe tash po e presim edhe leximin e dytë dhe besojmë që do të këtë impakt të madh sa i përket zhvillimit ekonomik lokal dhe nëse dëshironi unë mund ti theksoj rekomandimet të cilat kanë me pasë impakt pozitiv; Kryetarëve të Komunave do tu lejohet fillimi i negociimit me investitorë potencial jo vetëm në Republikën e Kosovës mirëpo edhe jashtë Republikës në takimet e ndryshme që Kryetarët e Komunave i kanë pasur me diasporën dhe kanë shprehur gatishmëri në investime në Komunitet e Kosovës mirëpo disa procedura burokratike të cilat kanë qenë në ligjin e kaluar nuk e kanë lejuar shumë diasporën që të bëjnë shumë investime dhe me këto ndryshime besoj që do të hapet një rrugë shumë pozitive sa u përket investimeve. Gjë tjetër është shkurtimi i proceduarve apo burokracisë d.m.th. shpallja e pronave në shfrytëzim në vend që ka qenë 30 ditë ka kaluar në 15 ditë d.m.th. janë shkurtuar disa procedura të cilat kanë qenë në ligjin e kaluar.

Pra në përgjithësi vlerësojmë që ndryshimet të cilat janë bërë në këtë ligj janë shumë pozitive. Ka kaluar leximin e parë, ka pasur zhvillime nga takimi i fundit i KKZHE-së dhe tash presim edhe leximin e dytë dhe këto janë zhvillimet sa i përket projekt-ligjit në fjalë. Ju faleminderit!

Endrit Shala, Ministër MTI

Kjo është një pikë ku kemi progres dhe si materie ka kaluar dhe është në shqyrtim në Parlament. Temë tjetër e propozuar Asociacioni i Komunave të Kosovës është edhe Plotësim–Ndryshimi i Ligjit për Partneritetet Publiko - Private (Ligji nr. 04/L-045). Përsëri e ftoj z. Sazan Ibrahimimi që ta prezantoj kërkesën lidhur me këtë temë dhe më pastaj do të flas edhe përfaqësuesi nga Ministria e Financave (MF).

Sazan Ibrahimimi – AKK:

Ju faleminderit edhe një here kryesues, është mirë që zv/ministri është këtu dhe nëse doni ju zv/ministër të thoni diçka pastaj unë mund të shtoj. Sa i përket këtij projekt-ligji, ka ngecje dhe mund të themi lirisht se nuk ka zhvillime si me Ligjin e dhënies se pronës komunale ne shfrytëzim. Neve si Asociacion, kemi theksuar që projekt-Ligji për Partneritet Publiko-Private është shumë esenciale sa i përket ndikimit në zhvillimin ekonomik lokal dhe duke i parë problemet të cilat i kanë evidentuar komunat në të kaluarën, neve kemi bërë propozime te Ministria e Financave përkatësisht te Drejtoria për Partneritetin Publiko-Privat, përsëri çështjet kryesore të cilat i kemi adresuar janë procedurat; kemi menduar që është mirë nëse vlera e investimit në partneritetet e propozuara publiko-private nëse nuk kalon 3% të investimeve atëherë procedurat të zhvillohen nga vetë Komunitet e Kosovës e jo të zhvillohen në nivelin qendror sepse po merr shumë kohë dhe po kemi procedura ne të cilat në disa raste nuk janë atraktive për partnerin privat. Për këtë arsye, ne kemi menduar për shembull nëse e marrim rast komunën e Prishtinës, nëse buxheti total 65 milion euro dhe nëse 3% i atij projekti pra nuk e kalon vlerën e 2 milionëshi atëherë është më mirë që këto procedurat të zhvillohen nga komuna dhe gjithë përgjegjësia duhet të bie në nivelin lokal e jo të shkojë në nivelin qendror ku po merr shumë kohë.

Neve jemi duke diskutuar me Njësinë për Partneritet Publiko-Privat, është zhvilluar koncept-dokument i mirëpo sa i përket amendamentit të këtij projekt-ligji ende nuk kemi parë ndonjë rezultat konkret. D.m.th. është vetëm puna e proceduarave besoj që komunat kanë kapacitete të zhvillojnë procedurat e Partneriteti Publiko-Privat dhe nuk ka nevojë që niveli qendror të ndërhyjë në procedurat që duhet të zhvillojë niveli lokal, janë këto dy çështje të cilat janë ngritur nga Komunitet e Republikës së Kosovës. Kemi pasur diskutime me të gjithë Drejtorët Rajonal për Zhvillim Ekonomik, Kryetarët e Komunave gjithashtu e kanë ngritur këtë çështje gjatë diskutimeve të cilat i kanë pasur në të kaluarën dhe shpresojmë që vërejtjet e Komunave do të inkuorohen në projekt-Ligjin për Partneritet Publiko-Private. Ne i kemi adresuar vërejtjet tona me shkrim. Ju faleminderit!

Fatmir Gashi – zv/ministër i Ministrisë së Financave

Ky ligj është në fazën përfundimtare d.m.th. koncept-dokumenti ka kaluar, tash edhe plotësim/ndryshimin e Ligjit dhe ka arritur në një fazë e cila është në përfundim dhe shpresojmë që me se largëti në mars do të vjen në Qeveri dhe do të procedohet në parlament. Ligji është diskutuar me Asociacionin, ne kemi qenë në diskutim me Departamentin e Shërbimeve Publike, ligji ka pas 4 qëllime të veta:

Harmonizimi me MSA-në dhe Direktivën Evropiane 2014/103 lidhur me përpilimin e kontratave mbi koncesionet dhe duhet me qenë në harmoni me atë direktive, kjo ka qenë sfida e parë dhe këtë që e përmendni ju është inkorporuar dhe do të jetë në ligj që komunat do të kenë të drejtë deri në 3% të hyrave të veta ti kryen procedurat vetë d.m.th. është pranuar që të eliminohet burokracia procedurale dhe është e pranuar mirëpo sfidë më të madhe po kemi me harmonizimin me ligjet tona; me ligjin mbi prokurimin, ligjin mbi ndihmën shtetërore, mbi borxhin publik, mbi ndërmarrjet publike, ligjin mbi Trepçën, etj. krejt këto janë ligje të cilat ne po duhet me pas kujdes që ky ligj mos të bie ndesh me këto ligje dhe këtu kemi pasë probleme dhe kemi edhe do të kemi konsultime të mëtutjeshme dhe unë shpresoj që në mars, kryesorja e kryesores është ajo që ju keni theksuar se është pengesë për komuna, ne e kemi inkorporuar në ligj dhe do të jetë në ligj dhe ne po themi që ligji është në fazën përfundimtare dhe gjatë shkurtit brenda Ministrisë sonë do ti kryejmë të gjitha konsultimet ligjore-juridike që i kemi dhe do e procedojmë në Qeveri dhe shpresojmë që ky Ligj së shpejti do të aprovohet. Ju faleminderit!

Ramush Haradinaj: Kryeministër

Duhet ta merr dikush sponsorizimin e temave. Unë kam raste prej anëtarëve të Kabinetit që temën që ka dalë prej Ministrisë së tij e ka harruar krejt, duhet të hiqet kjo praktikë. Kush e ka një temë duhet ta përcjell deri tek ne në Kabinet, kjo vlen për gjithë Ministrat dhe imagjinoni ju, tema që ti je sponsor p.sh. Ministria jote ose një Ministri tjetër dhe e harron, nuk e di ku është; në cilën etapë është apo në cilën fazë është. Një temë kush do që e ka sponsorizuar dhe nuk po dua me ju bo lavd këtu mirëpo e kemi rastin e ministrit Abelard Tahiri, një temë dhe ligjet e veta, qëndron pas tyre deri të kryhen dhe në fund e jep rezultatin. Ne kishim paketën ligjore që doli e përkryer. Ne po kemi probleme me disa kolegë, duhet me bo kujdes në të. Kohëzgjatja në raste te caktuara është me e madhe se sa realja ose koha reale që pritet për këto procese.

Endrit Shala, Ministër MTI

Para se të dalim në tema të tjera e kemi edhe një temë të propozuara nga AKK-së, dhe është mirë që qeveria tanimë veç ka proceduar me dy temat e propozuara paraprakisht.

Temë e tretë e propozuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës është "Menaxhimi i pronave të "Ekonomisë Pyjore" që menaxhohen nga Agjencia e Pyjeve të Kosovës (MBPZHR). Përsëri e ftoj z. Sazan Ibrahimimi që ta prezantoj kërkesën lidhur me këtë temë dhe më pastaj do të flas edhe përfaqësuesi nga Agjencia e Pyjeve dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR).

Z. Ibrahimimi fjala për ju...

Sazan Ibrahimimi - AKK

Kjo është një ndër temat që ka qene edhe më herët e propozuar. Ky problem është i njëjtë pothuajse me gjitha pronat të cilat janë të administruara nga Agjencia Pyjore e Kosovës (APK) mirëpo çka është diçka që mund mos të ndërlikohet me vendimet e Kryeministrit për dhënien e pronave nëpër Komuna të cilat vendime janë shumë të mirëpritura nga Komunat për shkak të zhvillimit ekonomik lokal. Këto prona të cilat menaxhohen nga Ekonomia Pyjore në shumicën e rasteve janë djerrina apo parcela pyjore ku vetëm shfrytëzimi i drurit është diçka që ka një impakt ndërsa pyetja është se çka ndodh me administrimin e këtyre pronave. Kryetarët e Komunave kanë kërkuar që mundësisht këto prona të cilat janë të pashfrytëzuara me dekada t'ju jepen Komunave në pronësi në mënyrë që të ndërlidhet me zhvillimin ekonomik lokal me çështje e investimeve sepse në shumicën e rasteve, Kryeministri është i njoftuar që kanë prona të cilat do të mund ti jepnin në shfrytëzim. Paramendoni një investitor potencial rishtazi ka kërkuar 200 hektarë pronë komunale dhe duhet të bëhet një rajon i tërë që ti sigurohet një hapësirë e madhe. Ne besojmë që tash Ligji për Pyje është duke u amandamentuar dhe shpresojmë që përfaqësuesi i Agjencionit të Pyjeve të na jap një informatë se çka është duke ndodhur dhe shpresojmë që Komunave t'u jepet e drejta për administrim mirëpo nëse nuk mund ti administrojnë ato prona t'u jepet e drejta në shfrytëzim vetëm për interesa publike dhe asnjë interes tjetër. Kemi pas bisedime me Kryeshefin dhe përfaqësuesin e Ministrisë dhe besoj se do gjejmë një gjuhë të përbashkët sa i përket kësaj temë.

Ahmet Zejnullahu, Agjencia e Pyjeve të Kosovës (APK)/MBPZHR

Sa i përket menaxhimit të pronave të Ekonomive Pyjore, në tërësi tokat dhe pyjet evidentohen si pronat e Ekonomive Pyjore. Edhe pse me plotësim/ndryshimin e Ligjit për Pyje në vitin 2010 të gjitha pronat publike janë prona të shtetit të Kosovës të cilat i menaxhon Agjencia e Pyjeve të Kosovës e ku një pjesë e kompetencave të vetë menaxhimit të pyjeve si: mbrojtja e pyjeve, dhënia e lejeve për prerje janë kompetencë e bartur te Komunat e Kosovës prapë se prapë ne kemi pas disa probleme të cilat sipas Ligjit për Pyje kanë pas kufizime sa i përket shfrytëzimit të këtyre tokave.

APK-ja si agjenci ekzekutive merret me menaxhimin dhe administrimin e pyjeve dhe tokave pyjore në Kosovë dhe janë diku rreth 288 mije hektarë pyje publike që evidentohen si prona të Ekonomive Pyjore. Ne kemi përgatitur Ligjin e ri për Pyje, i cili ligj është prej vitit të kaluar në zyrën e Ministrisë dhe ne kemi pritur që Ligji i ri sipas premtimeve të Ministrit është dashur që të procedohet në Qeveri për arsye se edhe në takimet me Komisionin Evropian është kërkuar që të përgatitet edhe Ligji i ri për Pyje dhe është pritur që gjatë vitit të kaluar të aprovohet në Parlament. Ky ligj ekziston dhe është në Kabinetin e Ministrit, dhe është punuar nga një grup punues ku përfaqësues kanë qenë edhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, prej Asociacionit të Komunave, ka pasur edhe prej Asociacionit Kombëtar të Pyjeve Private dhe të gjitha shqetësimet e komuniteti dhe Komunave kanë qenë të përfshira në Ligjin e ri për Pyje.

Mbetet që Ligji i ri për Pyje të procedohet në Qeveri dhe më vonë në Parlamentin e Kosovës, në mënyrë që edhe investitorët e mundshëm të kenë një mundësi shumë më të madhe se sa deri tash që kane pasë për arsye se ky ligj harmonizohet edhe me shumë institucione tjera dhe se dhënia në shfrytëzim e pronave të bëhet konform licencave që ata i japin. Gjithashtu, ajo që është paraqitur nga Asociacioni i Komunave në ligj kemi parapa që sipërfaqet të cilat janë djerrina dhe përfshihen në planin urbanistik të Komunave, ato t'u jepen komunave për shfrytëzim mirëpo duke pas parasysht peshën dhe rëndësinë që ajo me propozim të Agjencionit do të jetë në kompetencë të Qeverisë, pasi që pengesë e tanishme edhe për investitor edhe për komuna është Ligji i tanishëm i Pyjeve sepse kompetencat për pyje në Kosovë janë të shpërndara aq shumë sa që faktikisht komunat kanë pas më

shumë kompetenca. Me Ligjin e ri për Pyje, kompetencat do të delegohen në APK i cili do të jetë organi kompetent për menaxhimin dhe administrimin e pyjeve në Kosovë.

Për momentin, 28% e hapësirave pyjore menaxhohen nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ku janë shpallë 28% të pyjeve si parqe kombëtare dhe shumë herë ne i vërejmë që disa vendime të cilat merren përmes MMPH-së bëhen pa ndonjë konsultim sa i përket pyjeve në Kosovë. Mendoj që e vetmja situatë në Kosovë e cila do të kontribuonte në zhvillimin e përgjithshëm të sektorit pyjor është aprovimi i Ligjit të ri për Pyje.

Ramush Haradinaj – Kryeministër

Drejtor, duke e parë që po gjuhet topi në disa akterë, ju asociacioni, palët tjera e të shkoni me një listë të eliminimit të kërkesave; për shembull cila realizohet dhe qysh, këto që po i thoni në takim edhe pastaj nëse është plotësim/ndryshimi i Ligjit e marrim ne përsipër, nëse duhet të merret një vendim. E kam përshtypjen që njëfarë diskrepance mes nesh mundet me zgjate pa kufij, ne kështu jemi. Ju i dini prej perspektives tuaj, këta i kanë kërkesat diçka po mungon që nuk po lejon me ndodh në këto kërkesa të Asociacionit të Komunave të cilat janë lehtë të realizueshme. Është dashur të gjendet një formule që kur ulemi në takim dhe ne ato që biem dakord duhet ti japin një udhëzim kah, kush i kryen. Imagjinoni ne kur të ulemi herën tjetër, ne ti dëgjojmë prapë të njëjtat gjëra dhe nuk guxojmë të veprojmë kështu. Ne duhet të fillojmë ngadalë me dal në një fazë tjetër. Duhet të bëhen një treshe dhe duhet t'u ngarkojmë ne juve dyve (Sazanin dhe ju) edhe një kolegë tjetër qoftë nga APK-ja, apo ndonjë Ministri tjetër. Kush mendon se duhet të bëhet një grup me ju për me bo një propozim të përbashkët. Ju, Driton, Ministria e Mjedisit dhe një zyrtar apo ekspert dhe për takimin e ardhshëm të na jepni një listë të veprimit që duhet me i kry unë sepse unë nuk di si me i kry dhe Agjencia nuk varfërohet nëse i jep diçka Komunës apo anasjelltas, ajo është brenda Kosovës dhe kështu si po vlerësojmë sot me dal praktikë e gabuar pas 5 apo 10 vjet rikthehet sepse është brenda.

Sazan Ibrahim - AKK

Të gjitha këto shqyrtime janë diskutuar dhe janë marr për bazë për arsye se Grupi Punues për përgatitje e Ligjit të ri për Pyje ka pas në grup edhe përfaqësues të Ministrisë edhe të Asociacionit Kombëtar edhe faktikisht është çështja vetëm e rregullimit edhe e kalimit të ligjit. Ne mundemi edhe një here me u ulur edhe të shikojmë se çka mirëpo pothuaj se gjithçka është e dakorduar dhe çdo gjë që është identifikuar si problem qoftë nga Asociacioni i Komunave apo nga investitorët e ndryshëm janë ofruar zgjidhje dhe është përfshirë në draft-ligjin e propozuar.

Ramush Haradinaj - Kryeministër

Nëse doni me na ndihmuar duhet të kthehemi te disa vendime potenciale, pra te punët që ndodhin sepse nëse kthehemi për t'ja shpjeguar njeri-tjetrit këtë gjendje edhe një herë, kjo është varfëri për ne. Sot duhet të gjejmë formulën që kur të takohemi herën tjetër, ne e kemi një punë të kryer ose të gatshëm për vendim ose propozim-vendim dhe të ecim para.

Endrit Shala, Ministër MTI

Unë kisha kërkuar nga kabineti im që ta kryen detyrën e sekretariatit deri në funksionalizim e saj sepse besoj që Sekretariati do të bëhet shumë shpejt dhe secila temë që është diskutuar sot të procedohet në afatin më të shpejtë në ministrit e linjës dhe të kërkohet *feedback* për secilën temë.

Tani kisha kaluar në një teme tjetër nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë lidhur me "Bashkëpunimin në mes të shkollave profesionale me bizneset private për aftësimin e kuadrove të reja profesionale". Për të folur për këtë temë, e ftoj Ministrin Shyqiri Bytyqi nga MASHT që ta prezantoj këtë temë; dhe më pastaj rreth kësaj teme mund të kontribuojnë edhe përfaqësuesit nga komuniteti i biznesit.

Ministër Bytyqi e keni fjalën...

Shyqiri Bytyqi – Ministër MASHT

Të nderuar të pranishëm, në kuadër të prioriteteve që MASHT ka në programin e vet qeverisë Haradinaj ishte një prioritet kyç shkollat profesionale po ashtu dhe në kuadër të planit strategjik PSAP 2017 – 2021 luan një rol të rëndësishëm arsimit dhe aftësimi profesional duke pasur për baze këtë një aktivitet i jashtëzakonshëm është bërë gjatë vitit 2018 duke e pasur shtimin e bashkëpunimit me shumë partner ndërkombëtar dhe vendor si partner zhvillimor që kanë arritur objektiven e gjashtë dhe kanë bërë një hap tutje në bashkëpunimin për afrimin e zhvillimit të përbashkët mes të shkollave profesionale të arsimit dhe aftësimi profesional dhe bizneseve.

Në kuadër të kësaj, për herë të parë kemi filluar që të kemi mësimin në vendin e punës pra forma *duale* e cila ka për qëllim që nxënësit gjatë pjesës teorike të kryejnë edhe praktika direkte në ndërmarrje. Kjo ka filluar që në sektorin e përpunimit të drurit dhe të metal punuesve të kemi një mësim *dual* tash me nxënësit përveç mësimi teorik direkt kryen edhe praktikë në këto biznese. Është hartuar edhe rregulloja punës, pra kjo rregullore tash me është finalizuar e ka për qëllimin që nxënësit tanë ti mbrojnë gjatë pjesë në praktike që në rast të ndonjë aksidenti të kemi sigurimin e tyre që çështjet e lëndimeve të cilat mund ti pësojnë. Gjithashtu është finalizuar projekti për instruktor dhe shkolla dhe ndërmarrje, qëllimi i këtij projekti tash me është ndërtuar standardi përmes praktikës në shkolla dhe në ndërmarrje, tash me gjenerata e pare ka përfunduar nga 35 persona që kanë përfunduar këtë projekt që duhet të diplomojnë këtë muaj dhe kemi qëllim tu ju ndihmojmë praktiken edhe në shkolla edhe në ndërmarrje.

Po ashtu është harmonizuar dhe finalizuar Udhëzimi Administrativ që rregullon formën *duale* i cili udhëzim në vitin 2019 do ta këtë një rol kyç pasi që kemi shumë partner zhvillimor ndërkombëtar dhe vendor që janë duke u marrë direkt me zhvillim e mësimi *dual* veçanërisht dua të potencoj Qeverinë e Luksemburgut dhe Qeverinë Gjermane angazhim në disa shkolla-shembull të zbatimit të mësimi *dual* në shkolla profesionale. Po ashtu është hartuar dhe është finalizuar korniza *kurikulare* për sistemin e arsimit – aftësimi profesional dhe është dërguar tek bizneset për komentet e tyre presim ftesën që pas marrjes së komenteve nga bizneset të finalizomë dhe të aprovojmë edhe këtë kornizë. Gjithashtu kemi dërguar standarde profesionale rreth shkathësive, kompetencave për shkolla profesionale e cila është finalizuar dhe po ashtu është dërguar tek bizneset për të marrë komentet e tyre dhe për të inkuadruar pas kthimit të këtyre komenteve.

Gjithashtu në mungesë të kryerjes së praktikës në shumë sektorë tjera ministra në bashkëpunim edhe me shkollat profesionale e ka rritur numrin firmave ushtrimore të ashtuquajturat ndërmarrje virtuale aty ku nuk kemi mundësi direkt praktiken neper ndërmarrje, në kemi improvizuar ndërmarrjet në shkolla ku zbatohet praktika pra direkt në shkolla.

Gjithashtu është finalizuar projekti i studimit gjurmues i cili e ka një qëllim që pas përfundimi të shkollës profesionale të shohim se çfarë shkathtësi kanë fituar nxënësit dhe të përcillet një vit mbresa gjurmimi i tyre. Gjithashtu me qëllim të harmonizimit sa më të afërt të bizneseve dhe të shkollave profesionale në bashkëpunim me GIZ-in është bërë një hulumtim në 60 shkolla profesionale, në 8 Qendra të Arsimit Profesional dhe Qendra të Punës dhe Mirëqenies Sociale i cili e ka pas një qëllim që të bëhet analiza nga shkathtësia e fituar e nxënësve e deri tek financimi i këtyre shkollave në baze të kësaj tash më janë të identifikuar 15 standarde që janë me të kërkuara për tregun e punës dhe të cilat në bashkëpunim me AIN, në muajin janar do të fillohet që ti hartojmë edhe këto 15 standarde që do të nevojiten shkollave profesionale e që me pas këto standarde shkojnë sipas kërkesës së tregut të punës neper regjione. Ne presim një bashkëpunim që të kemi me biznese që të jemi në harmonizim sa më të mirë të programeve që janë të nevojshme për tregun e punës. Ju faleminderit!

Ramush Haradinaj - Kryeministër

Duhet ta krijojmë një praktikë të punojmë si Këshill. Nëse ne vijmë këtu për të elaboruar fortë temat atëherë duhet të marrim nga një javë kohe dhe ju e dini këtë e që ky forum nuk është për këtë punë. Të gjitha këto tema, si puna e arsimit *dual* mund të përgatiten nëse ka nevojë për vendime të Këshillit por nuk është vendi i prezantimit mirëpo është vendi i marrjes së vendimeve, në përputhje me atë që e bëjmë në mes të takime dhe ta kthej në punë për këtë arsye faza implementuese prej tash deri në takimin e ardhshëm duhet të ndodh ministër, pra nëse nuk ka Sekretariat edhe kabinetin juaj e kryen këtë punë ju lutem mos të ju ikën ndonjë detyrë e dalur prej këtij takimi dhe nëse keni pengesa na informoni para kohe mirëpo jo me ardhë në fund të takimit.

Nëse kemi shumë kohë të lirë dhe e kemi kryer rendin e ditës mund të ndalemi tek të ndryshmet. Arsyeja e kësaj është që nëse deri me datën 10 shkurt, ju mund të identifikoni tema tjera të nevojshme atëherë në mundemi të diskutojmë nëse nuk janë të gatshme për vendim dhe ju japim detyrë dikujt kush i zbaton dhe i bënë gati për vendimin e takimit të ardhshëm por ideja është që implementimi të ndodh dhe shpresojmë tash ti kthehemi një qasje tjetër dhe nëse jeni dakord me 26 shkurt është e martë kisha propozuar që të bashkohemi prapë dhe sa i përket orës nëse jeni dakord mundemi ta caktojmë në ora 10:00. Pra, me 26 shkurt, ora 10:00 takimi i ardhshëm dhe unë do të marr përsipër që mos të na mungoj ndonjë ministër sepse po e shoh që këtu nuk është Ministri i Ambientit dhe dikush tjetër d.m.th. 4 prej ministrave nuk janë këtu. Ju nga kabinetin i Ministrisë a dini ku me i dërguar temat. Si bëhet kjo punë e dhënies së kompetencave të Komunave për operim me rastin e Agjencisë; a është çështja e ligjit që duhet të avancohet deri në fund. A ka dalë ndonjë detyrë që ne sot duhet me krye deri në takimin e ardhshëm.

Sazan Ibrahim - AKK

Ligji është në Ministrinë e Bujqësisë dhe nga ata presim që të procedojnë më tutje në Qeveri.

Rea Kryeziu - OEK

Te nderuar te pranishëm

Ne pajtohemi dhe jemi dakord me idenë takimeve mujore sidomos nga fundi i muajit pasi që adresohen të gjitha temat të cilat ndodhin gjatë muajit dhe munden me pas një epilog të duhur. Oda Ekonomike i ka disa propozime për takimin e ardhshëm dhe besojmë se mundemi me ardhur në një dakordim se janë të rëndësishme për komunitetin biznesit dhe zhvillimit ekonomik atëherë e para kishte me qenë edhe si përcjellje të komentit të Kryeministrit, besojmë që duhet me pas monitorim të ecurisë së planit legjislativ sidomos të komponentës ekonomike dhe besojmë se ky Këshill është pikërisht vendi i duhur për ta bërë atë, ndoshta kishte me qenë mire për të prezantuar të gjitha ligjet të cilat janë planifikuar për vitin 2019 që te iniciohen dhe të kalojnë në Parlament dhe më pas do të ndodhte monitorimi i këtij Këshilli dhe të shohim ecurinë se a ka përparime dhe pjesa e dytë edhe pse thatë që nuk duhet të këtë prezantim të llojit të tillë në këto takime, ne besojmë se OEK do të mund të bëjë një prezantim karshi kësaj iniciativës për arsimin *dual* se si mund ta zhvillojmë atë me tutje, këtu mund të kemi edhe koordinim të donatoreve dhe përkatësisht me ato dy takime që po mbahen për koordinim për hulumtim e kutikulave, besojmë se mundet me pas koordinim dhe konsensus pak më të mirë pastaj ka komente pak ma specifike p.sh. Iniciimi i amandamentimit të ligjit për prokurimin publik, kjo vjen si kërkesë e bizneseve për shkak që neni 9, paragrafi 4, ka njëfarë aspekti preferencial sa i përket institucioneve publike dhe besojmë se kjo duhet të hiqej si nen po ashtu të mundësoj rritje të prokurimit elektronik dhe së treti të këtë përfshirje të arbitrazhit si zgjidhje e kontesteve në aplikim të kontratave dhe pastaj që të përfundohen të gjitha procedurat tjera. Iniciimi i amandamentimit të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe kjo është një kërkesë që vjen nga biznesi dhe me ministrin Shala kemi pasur takime të shumta për artikullin 16, po ashtu janë dhe dy prezantime të tij që janë të rëndësishme: prezantim nga Ministria e Drejtësisë lidhur me Gjykatën Komerciale, gjë që është kusht për tërheqjen e investitorëve të huaj dhe parakusht për siguri juridike se fundi një prezantim nga MTI-ja, lidhur me Ligjin për Tregti të Brendshme dhe Oda mund të ofroj bashkëpunim dhe koordinim.

Arian Zeka – kryetar i Oda Ekonomike Amerikane

Të nderuar të pranishëm, unë kam një propozim shumë të shkurtër dhe ka qene një ide që e din edhe z. Belegu që e ka hedhë në vitin 2013 por meqenëse takimet e KKZHE-së ndoshta nuk lejojnë për një prezantim të mirëfilltë atëherë te kemi diku kah muaji mars pasi edhe të funksionalizohet Sekretariati i ri, një *"retreat"* (punëtori) strategjik ku një deri në dy përfaqësues strategjik të anëtarëve të KKZHE-së, të mbahet një deri në dy ditë pune dhe të bëhen bashkë të vendosin kornizën e një plani nacional zhvillimor. E di qe ndoshta deri në vitin 2020 e kemi një të tillë që është i vlefshëm por i cili kur është aprovuar në vitin 2015 nuk ka reflektuar kërkesa e të gjithë neve aktualisht dhe nuk është diskutuar asnjëherë në KKZHE por ka qene me tepër produkt i organizatave donatore.

Pa e minimizuar këtë plan, ky mund të shërbej si një bazë e mirë fillestare që ne bashkërisht si KKZHE në një vit i cili është vit i zhvillimit ekonomik, të krijojmë një plan të ri dhe i cili pastaj shërben si bazë me disa shtylla të cilat ne do ti përcaktonim që pastaj të gjitha vendimet do të bazoheshin në të. Ju faleminderit.

Ramush Haradinaj - Kryeministër

Nëse ne i mbajmë takimet e Qeverise ndodh që ka pika se është prezantim i temës se caktuar mirëpo në shumicën e rasteve shkojmë në një formë më të avancuar dhe në japim një propozim në fund p.sh. është prezantimi i OEK për arsimin *dual* por ti në fund ja jep edhe një produkt KKZHE-se,

dhe i mundësohet Këshillit me ja dhanë edhe një efekt përpos informatës se pse nuk guxojmë të kalojmë në një lloj të tillë se ndryshon kuptimin e këtij mekanizmi, ne paraprakisht duhet të dakordohemi se a dëshirojmë ti dëgjojmë veç informata. Më mirë është të përgatitemi për propozime dhe marrje të vendimeve dhe atëherë ndodh diçka. Ideja e Arianit për takime paraprak është shumë e mirë mirëpo mos po ndodh të ndryshohet pastaj. Në këtë tryezë kisha lutur që të shkojmë nga temat e formuara dhe dëshiroj te kryejmë punë të cilat janë në listë.

Nora Hasani – drejtoreshë e Odës Ekonomike Gjermane në Kosovë

Përshëndetje te gjithëve! Unë ju përgëzoj shumë që këtë vit e keni vendosur fokusin në ekonomi, kjo është një gjë me interes të madh e në veçanti për neve si përfaqësues të sektorit privat. Këtu u përmenden dy fjale kyçe, të cilat dua të ndërlidhem menjëherë. Rëndësia e tërheqjes së investimeve të huaja në Kosovë dhe çështje e çalimit në implementimin e disa ligjeve kështu që meqenëse jeni këtu ministër Shala ndoshta mund të na tregoni se ku po çalon implementimi i Ligjit për Investime Strategjike, kjo është shumë e rëndësishme për disa investitorë potencial strategjik gjerman të cilët kanë aplikuar për ta marr këtë status dhe në veçanti për neve me qenë se ne e përdori si mjet për ti tërhequr investitorë tjerë ne Kosovë.

Endrit Shala, Ministër MTI

Unë nuk e kisha thënë se ky proces po çalon, unë i kam autorizuar disa ndryshime të Udhëzimit Administrativ për Aplikimin dhe Përzgjedhjen e Investitorit Strategjik, pas disa ankesa të pranuar nga investitorët potencial të cilët i kanë dhënë sugjerime MTI-së për disa çështje administrative. Udhëzimi i ri Administrativ, i cili e përcakton këtë aplikim veç është miratuar në Qeveri edhe ligjërisht është ne fuqi. Deri më tani, ne i kemi 11 investitorë të interesuar, një nga kompanitë e interesuara gjermane i ka plotësuar të gjitha kriteret edhe me udhëzimin e vjetër. Me qëllim të lehtësimit të procedurave të mëtutjeshme, që është vendimi pastaj i Komisionit Ndërmintor, vendimi i Qeverise dhe i Parlamentit, unë dhe MTI jemi duket menduar që të shkojmë me një pako dhe të shohim edhe nga investitorët e tjerë p.sh. mund të kalojnë statusin dy apo tre dhe pastaj të procedojmë me ata tre investitor strategjik në komision ndërministror, vendim të Qeverise dhe pastaj të kalon vendimi në Parlament. Një kompani veç është kategorizuar dhe shume shpejt edhe të tjerat.

Nora Hasani – drejtoreshë e Oda Ekonomike Gjermane në Kosovë

Ju faleminderit mirëpo ne dëshirojmë të shprehim përkrahjen tonë që ta ndihmojmë Qeverinë e Kosovës në tërheqjen e investitorëve gjerman kështu që këto informata janë shumë të mirëseardhura për ne. Në këtë vit e kemi synim që të punojmë me shumë në këtë drejtim bashkërisht me partnerët tanë në Gjermani, me Asociacionet ekonomike private mirëpo edhe me Rrjetin e gjithë Odave të Tregtisë dhe Industrisë Gjermane, ti shfrytëzojmë sa ma shumë që të bëjmë reklamë për Kosovën si vend për bashkëpunim por edhe investime e njëkohësisht të nxisim ndërmarrje gjermane që ta shohin edhe Parkun Teknologjik dhe Inovacionit në Prizren si opion për të investuar në Kosovë.

Endrit Shala, Ministër MTI

Ju faleminderit! Ju e dini që Agjencia i cili merret me promovimin e investimeve - KIESA, është i hapur dhe unë mirëpres edhe ndihmën e juaj, kështu që pa humbur kohe ju kisha ftuar që te jepni përkrahjen tuaj në këtë drejtim.

Ramush Haradinaj - Kryeministër

Unë e shoh që për të pasur një vit të suksesshëm duhet një Sekretariat i mirë, i suksesshëm, i aftë i KKZHE-së dhe ju kisha lutur që ti shpejtoni këto procedura nëse mundeni. Kemi shumë tema dhe punë mirëpo pa Sekretariat edhe vështirë dhe ju Ministër ta merrni parasysh këtë dhe ti zgjedhim temat e mira dhe të japim efektin me këto takime dhe ti fusim diskutimet e mirëfillta ku të raportohet çka ka ndodhur në mes të dy takimeve. Duam punë konkrete ti marrim investitorët që të mos enden nëpër Kosovë.

Endrit Shala, Ministër MTI

Nëse nuk kemi diçka për të shtuar, atëherë unë e shpalli të mbyllur këtë takim dhe takimi i radhës siç u dakordua është me 26 shkurt nga ora 10:00 dhe deri me datën 10-të, kabineti pret të gjitha tema nga anëtarët e këtij Këshilli që ti shqyrtojmë për mbledhjen e ardhshme.

Ju faleminderit!